

2 KKP e mirë për degën e elektricitëve Organizimi sindikalist sjell permirësim të kushteve të punës

3 Ligji i ri për të huaj dhe për integrim Kërkohe dëshmi të rrepta të aftësive gjuhësore

4 U nda nga jeta aktivisti sindikalist Ekrem Shaqiri Themelues i grupit sindikalist shqiptar në Kantonin Waadt (VD)

Nr. 6 | tetor 2019 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

Zgjedhjet federale 2019 Rrëshqitje e GJELBËR historike



Pamje nga Demonstrata e sivjetme kombëtare klimatike në Bernë: «Ne jemi ndryshimi»

Në mbrëmjen e 20 tetorit 2019, menjëherë pas njoftimit mbi rezultatet zgjedhore, politologu Lukas Golder foli për zgjedhje të «përmasave historike». Të Gjelbrit jo vetëm se kanë shtuar numrin e ulëseve si asnjë parti tjetër që nga viti 1919. BDP/PBD ka humbur të qenit grup parlamentar, ndërsa SVP/UDC nuk ka qenë më e dobët se sa në nivelin e vitin 1999. Pos tjerash që nga futja e sistemit votues proporcional edhe SP/PS nuk ka qenë më fortë e dobësuar.

Emine Sariaslan & Osman Osmani

Më 20 tetor qytetaret/ët zviceran kanë zgjedhur parlamentin e ri për katër vitet e ardhshme. Me rastin e këtyre zgjedhjeve në spektrin e majtë dhe atë sindikalist kanë dominuar temat si: Klima dhe mbrojtja e ambientit, barazia (gjinore), shëndetësia-sigurimet shëndetësore, mbrojtja e të drejtave të punëmarrësve, si deh një shoqëri e hapur dhe solidarë. Ndryshimet klimatike preokupon njerëzit e të gjitha ngjyrimëve politike, jo vetëm votuesit e majtë deh të gjelbër. Arkat e sigurimeve shëndetësore, siguria sociale dhe pensioni i pleqërisë dhe hallet tjera të mëdha të popullatës. Punonjësit duan paga korrekte. Kushtet e punës dhe të jetesës për shumë njerëz janë përkeqësuar. Njerëzit të cilët ende kanë një punë ia janë nënshtruar presionit. Sipas Caritas-it, në vitin 2016, mbi 1.2 milion njerëz në Zvicër kanë qenë të prekur apo të rrezikuar nga varfëria. Një e katërta e tyre janë fëmijë apo të rinj. Ndër ta mbi mesataren janë prindërit vetë përgjegjës për rritje e edukim të fëmijës, familjet

me tre apo me shumë fëmijë si dhe njerëzit me arsimim të ulët, të cilët pas humbjes së vendit të punës nuk gjejnë punë të re. Rritja e njerëzve të pensionuar që janë të varur edhe mbështesja shtesë është duke u rritur në vazhdimësi. Me fuqizimin e ligjit të ri për të huaj dhe integrim është rritur presioni ndaj migrantëve/ëve, të cilët/at nuk kanë punë apo nuk zotërojnë një gjuhë zyrtare të vendit. Zgjedhjet federale kanë paraqitur një rast për të votua ndryshimin në shoqëri.

Më të rëndësishmet shkurtimisht

«Zgjedhjet klimatike» 2019 janë kujdesur për shtyrjen historike të ulëseve në të mirë të Gjelbërve: me 17 ulëse plus, të Gjelbrit do të kenë 28 ulëse në parlamentin federal. Me 28 ulëse të Gjelbrit e lënë prapa CVP/PDC (25 ulëse) dhe i afrohen për një ulëseve FDP/PLR (29 ulëse).

Bashkë me Liberalët e Gjelbër kanë 44 ulëse në dhomën e madhe të

parlamentit federal. Për herë të parë pas historikut 171 vjeçar të Gjelbrit ia kalojnë me ulëse në parlament CVP/PDC-së. SVP/UDC humbë 11 ulëse, SP/PS humbë 5 ulëse dhe FDP/PLR ka 4 mandate më pak.

Krahasuatur me zgjedhjet e kaluara federale, SVP/UDC sipas pritjeve është humbësja më e madhe e këtyre zgjedhjeve. Ajo humbë 11 ulëse në parlamentin federal, megjithatë me 54 ulëse mbetet edhe më tej partia më e fuqishme.

«Ne tani kemi një bllok me përbërje krejtësisht të re» thotë më tej politologu Golder. Kur është fjala për politikën e majta, të Gjelbërit janë në lartësi thujta se të njëjtë me SP/PS. Dhe: «Liberalët e Gjelbër munda të luajnë role të reja ndikuese» thekson Golder.

Fituesja e zgjedhjeve Regula Rytz (kryetare e të Gjelbërve) ngrit me të drejtë pretendimin për një ulë-

se në qeverinë federale dhe kështu nuk përjashton mundësinë që të sulmojë ulësen e FDP/PLR në qeverinë federale. Rrëshqitja nuk është vetëm e gjelbër por edhe sociale. Sikur thotë në intervistat e saj Regula Rytz, se temat e të gjelbërve janë të ndërlidhura me temat sociale, sikur fjala bie barazia (gjinore), pensionet e pleqërisë AHV/AVS, Dumpingu në page, etj.

Lufta vijon më tej

Unia do të intensifikoi më tej bashkëpunimin me partitë, të cilat angazhohen për të drejtat e punëmarrësve dhe emigrantëve, për mbrojtjen e burimeve jetësor si dhe për drejtësi sociale. Për barazinë e grave deh burrave, jetësimin e të drejtave njerëzore Unia do të fuqizojë më tej bashkëpunimin me partitë dhe organizatat e shoqërisë civile, me shoqatat mjedisore, me krijuesit e artistët dhe lëvizjet shoqërore.

Editorial



Copyright: Neil Labrador/Levèment syndical

Të dalim nga kurthi i shfrytëzimit

Në alarmojmë. Mbretëron gjendje emergjence: emergjencë sociale dhe ekologjike. Janë vu në lojë shanset për një jetë me dinjitet dhe punë të mirë për të gjithë, demokracia dhe paqja.

Ka disa dekada që 1% e të pasurve bëhen edhe më të pasur – në kurriz të tjerëve. Këta super të pasur ekonomisë e tyre plaçkitëse e bëjnë në kurriz të themeleve tona jetësore natyrore. Andaj në lojë janë vu edhe: e ardhmja e njerëzimit dhe e ambientit.

Përearja sociale dhe emergjenca ekologjike: që të dyja të shkaktuara nga njeriu: Vepër e një «elite njerëzore» të vogël. Që të dyja janë pasoja të shfrytëzimit të pamëshirshëm të njeriut dhe ambientit.

- Të 26 miliardë të pasur – thujta se të gjithë meshkuj – posedojnë aq shumë sa së bashku e gjithë gjysma e varfër e popullsisë botërore, që janë 4 miliardë njerëz.
- 25 korporata janë përgjegjëse për mbi gjysmën të emetimeve industriale të CO₂ (dyoksid-karbonit) në të gjithë botën.

Në tani theksojmë: Mjaftë më me shfrytëzimin e njeriut dhe natyrës.

Bashkë do të thyejmë pushtetin e juaj të pamasë dhe të pasjellshëm.

Bashkë do të arrijmë që brenda një dhjetëvjeçari emetimet e CO₂ ti kthejmë në neto = zero.

Bashkë qëndrojmë për reduktimin urgjentisht të nevojshëm kohës së punës.

Bashkë arrijmë drejtësinë sociale dhe ekologjike.

Dhe ju, zotërinj super të pasur do të paguan për këtë!

Tani më në fund duam fakte! Ne duam një rimodelim të ekonomisë dhe shoqërisë. Dhe si sekretare sindikate unë theksoj qartë, që nuk ka rimodelim ekologjik-social pa drejtësi sociale. Ky është qëllimi ynë i përbashkët! JU faleminderit që luftoni bashkë me ne, sot dhe nesër. Bashkë jemi më të fortë!

Fjala e Vanja Alleva, kryetare e sindikatës Unia, mbajtur së fundi në demonstratën ekologjike

News

U nda nga ne aktivisti sindikalist Ekrem Shaqiri



Me keqardhje mësuam për rastin e vdekjes së Ekrem Shaqirit. Ai pas një sëmundje të rëndë vdiq në moshën 58 vjeçare më 13 tetor 2019. Punëtori i ndërtimeve Ekrem Shaqiri ishte njëri ndër personat më aktivë në sindikatën Unia të

regjionit Waadt (VD). Ai ishte shumë i angazhuar, ishte pjesëmarrës në protestat dhe aksionet e sindikatës si dehishte i deleguar në strukturat dhe organet sindikaliste të degës së ndërtimit dhe të migracionit. Ndër të tjera ai është angazhuar fuqishëm për të drejtat e personave pa leje qëndrimi (SansPapiers) në Zvicër. Ai i njihë shumë mirë rrethanat jetësore të këtyre njerëzve, pasi politikave zvicerane të migracionit për vite të tëra e bënë edhe vet Ekremi një SansPapiers. Ne u shprehim ngushëllimet tona familjarëve të tij.

Unia fiton në gjykatën federale: s'ka punë në ditët e festave

Gjyqi federal i jep të drejtë sindikatës Unia dhe kështu fuqizon gjykimet e deritashme: Sipas ligjit të punës personelit shitës nuk u lejohet që të punojnë ditëve të festave. Vendimi i Gjykatës federale është me rëndësi edhe në rrafshin kombëtar. Në shumë kantone në vitet e fundit janë dhënë leje të jashtëzakonshme pune për të dielave dhe gjatë festave, bile edhe për manifestime të parëndësishme dhe mjerisht për arsye komerciale. Kjo bie ndesh me ligjin e punës.

Rritje të pamjaftueshme pagash tek Migros-i

Në shumë raste, niveli i rritjes së pagave të negociuara në Migros është i pamjaftueshëm për të mbuluar koston e jetesës për punonjësit. Njësitë e ndryshme të ndërmarrjes tanimë duhet që të harmonizojnë shtrenjtimin jetësor për të ardhurat më të ulëta dhe të kujdesen për rritje pagash përkitazi me sigurimin e humbjeve të fuqinë blerëse të viteve të fundit. Unia kërkon gjithashtu të mënjanohet diskriminimi në paga dhe që të kontrollohen pagat në kuadër të barazisë në paga dhe transparencës së plotë të tyre. Në fund duhet që pagat tejet të ulëta në këtë sektor ku punojnë kryesisht gratë të ngritën dhe barazohen me nivelin e profesioneve që dominohen nga burrat.

Fillimi i bisedimeve tek Coop-i: Personeli është i gatshëm për të luftuar

Bisedimet për paga të shijes me pakicë, gjegjësisht tek Coop-i, fillojë tani. Një anketë e Unia me punonjësit e Coop-it tregon që 78% e punonjësve nuk janë të kënaqur me rritjen e pagave për vitin 2019. Uni kërkon një ngritje të përgjithshme pagash prej 2% si dhe mjete shtesë për të jetësuar rritjen. Me rastin e fillimit të bisedimeve Unia me 30 shtator 2019 dërgoi argumentet e punonjësve të Coop-it për ngritje pagash në Bazël. Këto argumente janë shënuar nga punonjësit e Coop-it nga e gjithë Zvicra në tytat blerëse dhe nga ana e delegacionit të Unia iu janë dorëzuar Coop-it.



Pamje nga aksioni i dorëzimit tek Coop-i i argumenteve të punonjësve të shënuara në tytat blerëse

Filiali i Postës duhe të paguajë pagat shtesë Shefat ish-in diktatorë të vërtetë

Shtypje ilegale e pagave dhe ngacmimet ish-in përditshmëri në filialin e Postës «Epsilon» të Gjenevës. Punonjësit kundërshtojnë dhe Posta duhet të paguajë diferencën e pagave korrekte.

Christian Egg, workzeitung, 27.09.2019 (Adaptuar nga Marília Mendes)

Shuma totale e pagesave shtesë është konfidenciale. Sipas emisionit informativ «10 vor 10» të televizionit shtetëror, ajo është rreth 600 000 Franga. Pos kësaj tanimë postierët kanë marrë një kontratë, e cila përbënë pagat minimale kantonale plus shtesën për punë natën. Kjo nuk ishte gjithmonë kështu.

Pagat shtypeshin prore

Arciniegas dhe kolegu i tij José Serantes (45) çdo mëngjes dërgonin gazetën nëpër kutit e postës. Të dy raportojnë për një gjendje të pambrojtur dhe antiligjore. Koha e tyre e punës nuk regjistron fare. Orari varej shumë nga moti. Në dimër, kur kishte borë, një ndërrim zgjaste më shumë, deri edhe në dyfishin e kohës. Megjithatë të ardhurat e José Serantes ish-in gjithmonë po të njëjtat, në të vërtetë njëherë 39 Franga në ditë, plus 9 Franga për benzinë. Një pagesë shtesë për punën natën, sikur parashihet ligji, nuk është paguar asnjëherë. Në muaj ai merrte 1200 Franga. Këto paga të varfra shefat e «Epsilon» i shtypnin më tej përmes ndryshimeve të kontratave shkarkuese, pra përmes kontratave tjera më të këqija me pagë edhe më të keqe.

Ishte mbushur kupa

Për Arciniegas dhe Serantes është e qartë: Firma i ka shfrytëzuar, pasi ata janë



Dy nga punonjësit protestues, të drejtat e të cilëve u nëpërkëmbën nga «Epsilon»

të huaj. Serantes vjen nga Spanja, Arciniegas është kolumbian. Ai thotë: «Ne i kemi pranuar të gjitha, pasi ne nuk e kemi ditur, se çka vlen në Zvicër.» Kur «Epsilon» të gjithë të 80 kontraktuesve ua komunikoi ndryshimin e kontratës shkarkuese, për tua shtypur përsëri atyre pagat, u ngritën rreth 40 punonjës dhe iu drejtuan tek Unia. Emisioni televiziv «10 vor 10» raporton mbi «Dum-

ping paga në korporatën e Postës». Në fund Posta donë të negociojë.

Shefat u shkarkuan

Arciniegas ishte pjesë e delegacionit, i cili bisedoi me shefin më të lartë të personelit të Postës. «Për shtypjen e pagave Posta nuk kishte dijeni!». Shefate e «Epsilon» në Gjenevë i kishin përshtatur shifrat. Në ndërkohë ata janë shkarkuar.

KKP e mirë për elektricitet/ët Një rezultat, i cili nuk ka pikur nga qielli

KKP e sektorit elektrik përfundon në fund të 2019 andaj ai duhet të ri negociohet. Falë mobilizimit të elektricistëve/ëve, angazhimit të aktivistëve sindikal nëpër ndërmarrje si dhe falë sindikatës Unia u arritën përmirësime të rëndësishme në tryezën e bisedimeve.

Hilmi Gashi

Lufta e elektricistëve/ëve për një kontratë më mirë kolektive të punës ia ka vlejtur. Përmes një fushate të fuqishme elektricitet/ët me sindikatën e tyre Unia kanë arritur ndryshime të shumta në kontratë, e cila hyn në fuqi me 1 janar 2020.

Rroga dhe shpenzime më të mira: nga 1 janari 2020 do të ketë një rritje reale e rrogave prej 100 Frangash, duke shtuar edhe përshtatjen e shtrenjtimit jetësor prej 0,2% (Gjendja e muajit gusht). Nga 1 janari 2021 pagat minimale rriten deri në 550 Franga në muaj në 5 vitet e para

pas arritjes së certifikatës së aftësisë profesionale. Pos kësaj do të ketë edhe rrogë të 13 për të gjithë shegertëve. Kompensimi për të ushqyer jashtë do të rritet nga 12 në 16 Franga.

Më shumë ditë trajnimi e arsimimi të mëtejme: 5 ditë të paguara trajnimi, në vend të 3 si deri më tani. Kjo është me rëndësi të veçantë duke pasur parasysh sfidat e digitalizimit.

Koha e punës: Më shumë autonomi sa i përket kompensimit të orëve të tepërta të punës. Në fund të vitit të punësuarit mund të zgjedhin, se si duan ti kompensojnë gjysmën e orëve të tepërta.

Ose përmes pushimit me kohëzgjatje të njëjtë në datat e zgjedhura lirshëm, apo me pagesë.

Pensionimi i mëhershëm: Do të zbatohet një studim fizibiliteti mbi fuqizimin e pensionimit të mëhershëm me 62 vjet. Kjo është një shenjë se ideja po fiton në teren të përshtatshëm edhe tek punëdhënësit.

Një fushatë nën tension

Ky rezultat u arrit falë një fushate mobilizuese të gjer të Unia tek elektricistët/ët në të gjithë Zvicrën. Gati 4500 persona kanë nënshkruar një peticion në të mirë të kushteve të punës dhe kanë protestuar në Cyrih. Ndodhi e jashtëzakonshme në këtë sektor.



Pamje nga protesta e elektricistëve/ëve ne Cyrih të mbështetur edhe nga sindikata Unia

Sukseset nuk pikin nga qielli

Të gjitha këto përmirësime i kanë mundësuar elektricistët/ët e organizuar në sindikatë. Ata janë angazhuar për të ardhmen e këtij sektori dhe kjo tani u shpaguehet të gjithëve. A njëh Ti koleg/e të tjerë/a që nuk janë anëtarë në Unia. Atëherë mund ti tregosh për suksesin e arritur dhe ta përfitosh atë për sindikatë. Me anëtarësim fuqizohen punëdhënësit.



Situatë e pasigurt e të punësuarve 55 deri 64 vjeç Për përfitime të përkohshme për të moshuarit e papunë

Sot pjesëmarrja në punë e personave 55 deri 64 vjeçar është aq e lartë sa nuk mbahet mend. Mirëpo jo të gjithë personat e kësaj moshe që numërojnë në popullatën e punësuar dhe jo të gjithë kanë një vend pune të sigurtë, e kundërta. Në radhë të parë në vitet e fundit është rritur presioni karshi punëmarrësve në moshe të shtyrë dhe ka rritur pasigurinë e tyre, në radhë të dytë papunësia e punëmarrësve të kësaj moshe ka shënuar rritje të vazhdueshme.

Marrë nga ueb faqja e SGB/USS (Adaptoi O. Osmani)

Kuota e punësimit të kësaj grup moshe është rritur nga 66% në vitin 1999 për 10% në 76% në vitin 2019 – për shkaqe të ndryshme. Nëse mbeten të papunë, punëmarrësit në moshë kanë dukshëm probleme më të mëdha se sa më të rinjtë për të gjetur përsëri një vend tjetër pune. Përderisa kuota e asistencës sociale mes viteve 2011 dhe 2017 është rritur gjithsej për 10%, tek grup moshë mbi 55 vjeç kjo rritje ka qenë 32%. Punëkërkuessit e moshuar e kanë të vështirë. Ata shkruajnë shumë aplikime dhe megjithatë refuzohen, sh-

pesh me arsytetime joserioze. Mund të vihet në përfundim, se punëmarrësit e moshuar shënojnë rrezikshmëri të lartë të përjashtimit nga tregu i punës dhe përfitimit nga sigurimi i papunësisë dhe në të njëjtën kohë shanse të ulëta të ri integritimit.

Shanset, që në moshë të shtyrë pas përjashtimit përsëri të arrihet inkuadrimi në tregun e punës, janë tejet të vogla. Kjo për secilin nga të prekurit/at është një përvojë e dhimbshme – si psikike ashtu edhe financiare.

Paralelisht me masat parandaluese si p.sh. mbrojtje më të mirë kundër shkakimit nga puna, përmirësim të trajnimit dhe mbrojtje nga diskriminimi i të moshuarve, është absolutisht e domosdoshme që më në fund boshllëqet ekzistuese të pasigurisë sociale në moshë të para pensionimit të mbyllen. Andaj, nisur nga ky sfond, propozimi i këshillit federal për futjen e përfitimit të përkohshëm për të papunët e moshuar është një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm, të cilin e përshëndet edhe SGB/USS (Bashkimi i Sindikatave të Zvicrës).



Pushimi për etër dhe kujdesi për familjarët Përmirësime për prindër dhe për kujdes të familjarëve

Parlamenti zviceran ka vendosur: Etërit guxojnë të kujdesen për fëmijët e tyre të posalindur. Përmes kësaj u arrit të realizohet gjatë kohë e shtruar nga të majtit: Edhe personat në marrëdhënie pune, të cilët kujdesen për familjarët e tyre nevojtarë, i janë afruar një hap më afër lehtësimit.

Marek Wieruszewski

Pushimi për etër

Parlamenti zviceran ka vendosur për dy javë pushim atërie. Kjo i lejon etërit që brenda gjashtë muajve të parë pas lindjes së fëmijës, të marrin pushimin e paguar pjesë-pjesë apo përnjëherë. Për financim do të paguhet 0,06% kontribute shtesë, përgjysmë nga punëdhënësi dhe punëmarrësi. Vendime të ngjashme do të ndërmerren edhe nga BE-ja. Një direktivë përkatëse, e cila garanton ditët e pushimit të paguar, duhet të jetësohet nga shtetet anëtare më së voni deri me 2 gusht 2022.

Iniciativa e tërhequr

SI pasojë e vendimit parlamentar, deputeti i PSD Adrian Wüthrich, kryetar i shoqatës «Pushim për etër tani», pas një mëdyshjeje ka tërhequr me kushtëzim iniciativën, e cila kërkonte katër javë pushimi për etër. Nëse nuk zhvillohet referendum kundër kësaj zgjidhjeje, do të hyjë në fuqi pushimi i paguar dy javësh për etër. Kjo do të jetë e mundur tek me 1 qershor 2020.

Kujdesi për familjarët

Parlamenti federal ka aprovuar një ligj, sipas të cilit personat e inkuadruar në punë, e të cilët kujdesen për familjarët e sëmurë, do të mund të ndihmohen. Prindërit e fëmijëve të sëmurë rëndë, do të kenë të drejtë në 14 ditë pushimi për tu kujdesur për ta. Prindërit kanë mundësinë që këto ditë ti ndajnë lirshëm mes veti. Pushimi mund brenda 18 muajve të merret pjesë-pjesë apo përnjëherë. Për kujdesin e anëtarëve të tjerë të familjes – ndër ta edhe partnerët jetësor – parlamenti federal ka lejuar 10 ditë të paguara pushimi. Ky propozim tani shkon për aprovim në senat.

Ligji i ri për të huajt dhe për integrim

Kërkohen dëshmi të rrepta të aftësive gjuhësore

Ligji i ri për të huajt dhe për integrim (AIG/LEI), i cili ka hy në fuqi nga 1 janari 2019, shënon disa ashpërime në lëmin e të drejtave të të huajve. Të prekurit duhet të informohen mirë dhe të ngulin këmbë në të drejtat e tyre. Në vijim disa mundësi veprimi sa i përket aftësive të kërkuara gjuhësore.

Për kënd vlen AIG/LEI?

AIG/LEI rregullon veçanërisht lejimin dhe qëndrimin në Zvicër të shtetasve që nuk janë nga shtetet e BE/EFTA-s. Për shtetasit e BE/AFTA-s para së gjithash përcaktuese është Marrëveshjeja për lëvizje të lirë të personave. Edhe lejet e përhershme të qëndrimit C rregullohen përmes AIG/LEI.

Cilat janë rritjet e AIG/LEI?

AIG/LEI definon rishtas kriteret e integritimit. Këto janë përcaktuese për dhënien, degradimin apo edhe tërheqjen e lejeve. Njëri nga këto kriteret është aftësia e komunikimit në njëren nga gjuhët zyrtare (jo dialektet) të vendit. Kërkohen nivelet vijuese të njohurive gjuhësore: A1 me gojë për leje qëndrimi vjetor; A1 me shkrim për lejen e përhershme të qëndrimit; B1 me gojë, A1 me shkrim për lejen e përhershme të parakohshme; B1 me gojë, A2 me shkrim për marrje të shtetësisë. Secili Kanton mund të përcaktojë një nivel ë të lartë. Andaj është me rëndësi, informimi në Kantonin dhe Komunën banuese.

A ka përjashtime nga obligimi për të dëshmuar aftësitë gjuhësore?

Po. Të përjashtuar nga ky obligim, janë personat, të cilat kanë kufizime në të mësuar apo arsye me peshë, të cilat pengojnë të mësuarit e gjuhës. Për shtetasit e Belgjikës, Danimarkës, Gjermanisë, Francës, Austrisë, Portugalisë, Spanjës nuk guxon të varet dhënia, tërheqja apo degradimi i lejeve të përhershme të qëndrimit (leja C) nga aftësitë gjuhësore.

Si mund të dëshmohen aftësitë gjuhësore?

Ligji është qartë: «Aftësitë për nevoja migrimi vlejné të dëshmuara, nëse personi fole dhe shkruan gjuhën vendore sikur gjuhën amtare; përgjatë tri viteve ka ndjekur shkollën obliguese në gjuhën zyrtare të vendit; një arsimim të shkallës sekondare II apo të nivelit terciar në një nga gjuhët zyrtare të vendit; apo nëse posedon një dëshmi të posedimit të aftësive gjuhësore dhe që mbështetet në proceduar e dëshmimeve gjuhësore, me standarde kualifikuese përgjithësisht të njohura të testeve gjuhësore.» (neni 77d, pika 1 AIG/LEI)

Çka duhet bërë, nëse shtetasi/ja e një shteti jo anëtarë të BE/EFTA-s nuk e zotëron gjuhën lokale?

Këta persona duhet gjithsesi të ndjekin kurset gjuhësore. SEM (Sekretariati për Migracion) përcakton, se cilat certifikata gjuhësore vlejné si dëshmitë aftësive gjuhësore në procedurat ligjore të shtetasve të huaj. Andaj është me rëndësi të ndiqet një kurs, i cili mundëson marrjen e një certifikate të tillë.

Edhe në rast kur aftësitë gjuhësore nuk janë relevante për marrjen e lejes, do të duhej mësuar gjuha, për të njohur të drejtat e tija. Drejtohuni tek sekretariati juaj, Unia organizon kurse, gjejjësisht nuk e dinë se si bëhet ankesa, duhet gjithsesi të kërkohet ndihmën e sekretariatit të tyre të Unia-s. Është me rëndësi që secili të luftojë për të drejtën e tij dhe që në rast padrejtësie të bëhet ankesa.

Unë njoh situata, në të cilat zyrtarët për migracion kërkojnë aftësi gjuhësore apo dëshmi, edhe kur nuk do të duheshin. Çka mund të bëhet në raste të tilla?

Gjithsesi duhet ngulur këmbë në të drejtën ligjore dhe bëhet ankesa ndaj një vendimi të tillë. Në secilin vendim të autoriteteve është e shënuar edhe mundësia e ankesës dhe afati i vlefshëm. Me rëndësi është në rast ankese të respektohet afati dhe që ankesa të arsyetohet mirë. Anëtarët e Unia, të cilët janë të pasigurt se a duhet të ankohen në vendimin e autoriteteve, gjejjësisht nuk e dinë se si bëhet ankesa, duhet gjithsesi të kërkohet ndihmën e sekretariatit të tyre të Unia-s. Është me rëndësi që secili të luftojë për të drejtën e tij dhe që në rast padrejtësie të bëhet ankesa.

Marília Mendes

Ju pyesni, Unia përgjigjet

Shtesat familjare: Si qëndron puna tek punësimit e pjesshme??

Ja ndarë frik. Vajza jonë 8 vjeç do të jetojë tek unë. Andaj në të ardhmen unë do të marrë shtesat familjare. Para pak kohësh kam dëgjuar se për të marrë shtesat familjare eksiton një kufi minimal i të ardhurave, i cili është diku në shumën 500 Franga në muaj. Unë kam rregullisht shumë vende pune të pjesshme në firma të ndryshme. Tek njëra nga këto firma unë fitoj nga secila rreth 500 Franga. A më takojnë megjithatë shtesat familjare?

Myriam Muff: Po. Sipas ligjit federal mbi shtesat familjare, të drejtë në shtesat familjare ka kushdo që paguan kontributet e AHV/AVS për gjysmën e shumës së pensionit të plotë minimal. Pensioni i plotë minimal i AHV/AVS tani për tani është 14 220 Franga. Gjysma e saj është 7110 Franga, pra 592.50 Franga në muaj. Nëse një person është i punësuar tek shumë punëdhënës, atëherë llogariten të gjitha të ardhurat bashkë. Kur ju thonë, se rregullisht jeni të punësuar në vende pune të pjesshme, e nga secila prej tyre fitoni rreth 500 Franga, me siguri se arrini dhe kaloni kufirin e të ardhurave prej 7110 frangave në vit dhe me këtë keni të drejtë të shtesat (e plota) familjare. Lartësia e tyre ndryshon nga Kantonit. Megjithatë deri në ditëlindjen e 16 të fëmijës ju do të merrni së paku 200 Franga (shtesa të fëmijëve) në muaj dhe pas ditëlindjes së 16 së paku nga 250 Franga në muaj (shtesa arsimore).

Work, 13.9.2019

Afati i shkarkimit gjatë kohës provuese: Sa zgjatë ai?

Unë në verë kam filluar një punë të re dhe gjatë kohës provuese kam marrë shkarkimin nga puna. Dhe këtë me një afat vetëm prej një dite. Në kontratën e punës qëndron vetëm se koha provuese zgjat tre muaj. Në lidhje me afatin e shkarkimit nuk qëndron asgjë. Unë kam kujtuar se gjatë kohës provuese afati i shkarkimit është shtatë ditë. Shefi im në lidhje me këtë mendon se kjo nuk është detyrim ligjor dhe thotë se gjatë bisedës së inkuadrimit tim paska thënë se afati i shkarkimit gjatë punës provuese është një ditë. A është kjo e ligjshme?

Myriam Muff: Jo. Ligji në parim thekson se gjatë kohës provuese të muajit të parë afati i shkarkimit është shtatë ditë. Mirëpo se lejon devijimet vetëm përmes marrëveshjes me shkrim, p.sh me kontratën e punës me shkrim apo edhe përmes Kontratës Kolektive të Punës. Përderisa në kontratën tuaj të punës nuk është shënuar afati i cektor nga shefi i juaj prej një dite dhe nëse nuk ekziston marrëveshje me shkrim mbi këtë çështje, atëherë vlen afati i shkarkimit prej shtatë ditësh. Sa i përket kohëzgjatjes së punës provuese, koha e punës provuese e shënuar në te prej tre muajsh është e lejuar. Me këtë rast fjala është kohëzgjatjen e lejuar maksimale bazuar në të drejtën obliguese.!

Work, 13.9.2019

Kujdesi për fëmijën: Kush i merr kreditë edukuese të AHV/AVS?

Unë dhe partneri im së shpejti do të bëhemi prindër. Ne nuk jemi të martuar. Në ardhmen ne të dy duam të punojmë pjesshëm dhe të marrim përsipër gjysmë për gjysmë kujdestarinë për fëmijën. Unë kam dëgjuar se kush kujdeset për fëmijën merr edhe kreditë edukuese të AHV/AVS. A qëndron kjo? Dhe çka domethënë kjo në rastin tonë?

Philip Thomas: Kjo është korrekte. Tek AHV/AVS vetëm ju personalisht merrni kreditë edukuese për një apo më shumë fëmijë të moshës nën 16 vjeç, për ç' arsye keni punua vetëm pak apo hiq fare. Kreditë edukuese janë kompensim për punën edukuese të prindërve. Përmes kësaj kredie do të rritet edhe pensioni i AHV/AVS. Nëse si prindër të pamartuar ushtroni përkujdesjen e fëmijës bashkërisht, atëherë këtë duhet ta rregulloni ose përmes njohjes së atësisë tek zyra e gjendjes civile, ose ta lajmëroni tek autoriteti për mbrojtjen e fëmijëve. Me këtë rast mund të sqaroni ndarjen e kreditë edukuese: ekziston mundësia të ndahet kredia ose si e plotë ti llogaritet njërit prej prindërve. Me këtë rast duhet pasur parasysh se cili nga prindërit e kufizon më shumë marrëdhënien në punë. Ai prindër, i cili do të kalon kohën më të shumtë të përkujdesjes së fëmijës së përbashkët, duhet të shkruhet kredia e plotë edukuese. Një ndarje ka kuptim kur të dy pjesët e prindërve ne masë tërësisht të barabartë përkujdesen për fëmijën. Nëse situata ndryshon, mundeni në çdo kohë të adaptoni modelin e ndryshuar të kujdestarisë.

Work, 30.8.2019

U nda nga jeta aktivisti sindikalist shqiptaro-zviceran – Ekrem Shaqiri

Siç njoftojnë familjarët, sot me 13 tetor 2019, pas një sëmundjeje të rëndë, në moshën 58 vjeçare u nda nga ne aktivisti sindikalist shqiptaro-zviceran, Ekrem Shaqiri me prejardhje nga Kumanova e me vendbanim në Rennes të Kantonit Waadt (VD).

Osman Osmani

I ndjeri Ekremi ishte një aktivist i dalluar dhe pjesëmarrës në aksionet e protestat sindikaliste si dhe pjesëmarrës i rregullt në organet e strukturat sindikaliste në Zvicër.

Ai vepronte aktivisht në kuadër të grupit të interesit të migracionit në sindikatën Unia për Kantonin Waadt (VD) si dhe ishte i deleguar në komisionin nacional të migracionit të sindikatës Unia.

Pos tjerash, ai u shqua për mbështetjen e personave pa status të rregulluar (SansPapiers) në Zvicër, pasi që rrethanat jetësore dhe politikat e migracionit të Zvicrës edhe atë e kishin shndërruar në një «SansPapiers».

Ekremi ishte pjesëmarrës i rregullt

në thuaja se të gjitha aktivitetet e sindikalistëve shqiptaro-zviceranë. Ai ishte i rregullt edhe në seminaret vjetore të sindikatës Unia në gjuhën shqipe, shpesh edhe me familjarët e tij.

Pikërisht me iniciativën e Ekremi edhe në Kantonin Waadt (VD) mbështetur nga sekretari sindikal Arben Krasniqi, në shembullin e sindikalistëve shqiptar të regjionit Cyrih-Shafhauzen edhe në Lozanë u krijua grupi i sindikalistëve shqiptarë të Unia për Kantonin Waadt (VD).

Familjarëve, fafesisit, miqve, kolegëve sindikalistë dhe shokëve të Ekremi u dëshirojmë forcë për tu përballur me humbjen dhe pikëllimin.

Lavdi jetës dhe veprës së aktivistit Ekrem Shaqiri!



I ndjeri Ekremi me bashkëshorten dhe djalin në seminarin vjetor të verës së sivjetme në Spiez

Shqiptarët dhe emigrimi Largimi: Çfarë plage po rrjedh!

nga Edlira Gjoni, aktiviste e Organizatës Politike

Në një sallë me 120 gjimnazistë maturantë, pas një filmi për emigracionin, i pyeta të pranishmit: «Ndonjëri prej jush do ikë nga Shqipëria?»

U ngritën aq shumë duar sa nuk u besojta dot syve. Ndryshova pyetjen: «Sa prej jush NUK duan të ikin nga Shqipëria?» – pyeta e shastisur. Mezi u ngrit një dorë në cep.

«Ngrije dorën pak më shumë të lutem, – iu drejtova me fjalë e me shpresë. – Na thuaj edhe për këta 119 të tjerët arsyet e këtij vendimi të bukur»

Ajo hezitoi pak. «Do merrem me politikë» – tha, pak si me droje.

.....



Foto: Emigranti - Agim Sulaj

Po këta të tjerët? Çfarë di një 17-vjeçar se ç' është ikja? Pse 119 vetë nga 120 ishin pjesë e kësaj psikoze të frikshme?

Nga forum, e ktheva në fokus-grup masiv pa asnjë rregull shkencor, por shkues për gjendjen me të cilën u përballa.

«Djali aty në mes, që po kërkon mikrofonin me duar e me këmbë, pse do të ikësh? Çfarë e shtyn një 17-vjeçar të ketë këtë mendje?»

«Nuk kam besim se do gjej punë.»

«Po ti je 17 vjeç. Akoma në gjimnaz. Ke edhe 5 vjet sa të mbarosh universitetin.»

«Kam vëllain e motrën në shtëpi me universitet. Me punë në Call Centre motra. E në dyqan elektroshtëpiakësh vëllai»

«Po dhe po ike, a nuk janë këto punët që ju presin?»

«Po jo me këto rroga. E jo me këtë gjendje.»

Ja rrëmbejnë mikrofonin nga dora njëri-tjetrit.

«Unë dua të iki të studioj në Finlandë, që kur të mbaroj, të gjej punë atje më kollaj.»

«Unë dua të iki në Danimarkë. Atje nuk dalin politikanët në televizor e ngasin makina si të tjerët.»

«Unë edhe në Turqi shkoj, vetëm të mos i shoh më këta njerëz që na mbyten që kur kemi lindur.»

«Unë po bëj çdo përpjekje të shkoj në SHBA se atje kam mundësi më të shumta.»

«Më ka dalë bursa për në Izrael. Do shkoj me idenë që të rri andej.»

17 vjeçar! Shokimi i parë nuk më linte të analizoja ftohtë.

Thjesht mendoja që janë viktima të një psikoze të çoroditur, kur të gjithë duan të ikin nga gjithçka.

Por mbyllja e shkollave, e klasave, e regjistrimeve më të ulëta se kurrë më parë nëpër shkolla, e bllokun logjikën fare. «Po ç'nxitoheni kot? Prit ta provoni ju në kurriz politikën e punën. Ka punë për të tërë. Në portalet publike, në sektorin privat, në organizatat ndërkombëtare» – po mundohesha të isha motivuese.

«Po çfarë thua? Falso të gjitha! Shteti gënjen. Vetëm me parti. Privati të shfrytëzon me 150 mijë lekë rrogë. Organizatat ndërkombëtare janë rrjeta merimangash. Asnjë lajmërim për punë i tyre nuk është i vërtetë. 'Fake news' i kanë të tëra!»

Edhe flisnin me aq mllef e bindje, sa të çarmatosin qartësinë.

«Madje edhe trajnimet i kanë qesharake. Nuk duam të vemi më. Trajnim, trajnim! Do e ndryshojnë botën nga sallat e konferencave këta?»

«Do ikim që ç'ke me të! Mirë punë e para që s'ka, por as respekt për ne nuk ka këtu...»

Jam e shokuar!

Nuk e di nëse i njihni 17-vjeçarët e sotëm!

Nuk hanë politikë. Nuk e njohin propagandën. Janë imunë ndaj idiotëve e gënjeshtreve në emër të tyre.

Çfarë drame! Sa i gjatë paska qenë ky tunel?!

Zbrazja nuk mbaron deri sa baronët e politikës të falin njëri-tjetrin e të nisim edhe një herë nga viti zero në drejtësi